E enjte, 17 tetor 2023

[Seancë e hapur]

[Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

--- Seanca fillon në orën 10.00

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretare e Gjykatës, ju lutem paraqisni lëndën.

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar Gjykatës, kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

Mirëmëngjesi të gjithëve. Kemi disa çështje paraprake që duam të trajtojmë.

Sa i takon planifikimit, ne synojmë të bëjmë 10.00 deri në 11.30, gjysmë ore pushim deri në 12.00, pastaj në orën 13.30 do fillojmë pushimin e drekës. Pushimi i drekës do të jetë vetëm një orë, dhe do kthehemi në sallën e gjyqit në orën 14.30 deri në 16.00 si zakonisht. A jeni dakord të gjithë me këtë? Në rregull.

Përpara se të vazhdojmë me dëshminë, ka disa çështje paraprake që dëshiroj të trajtojmë. Fillimisht, Trupi Gjykues do të marrë vendim lidhur me kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit sa i takon pranimit të disa materialeve që iu paraqitën dëshmitarit numër 03880 gjatë dëshmisë së tij.

Trupi Gjykues rikujton se Mbrojtja e Thaçit dhe ZPS-ja

kanë dorëzuar parashtrime me shkrim më 13 tetor 2023, përkatësisht me parashtrimet e protokolluara F01855 dhe 01856.

Trupi Gjykues vëren se pranimi i disa prej këtyre materialeve nuk ka pasur -- nuk është kundërshtuar nga ZPS-ja. Këto janë dy shënime zyrtare të ZPS-së, një artikull në shtyp dhe një fragment nga LinkedIn-i dhe një segment videoje. Materialet i janë paraqitur dëshmitarit 03880 gjatë dëshmisë që dha më 9 dhe më 10 tetor 2023.

Sa i takon këtyre materialeve, Trupi Gjykues është bindur se kërkesat e rregullës 138(1) janë përmbushur. Rrjedhimisht në bazë të nenit 40(6)(h) të Ligjit dhe rregullës 138(1) të Rregullores, materialet që do të përmend më vonë pranohen dhe do të marrin numrin e provës materiale. Konkretisht bëhet fjalë për materialet 112748 deri 112750 RED bashkë me përkthimin në shqip që mbaron me AT-RED; materiali 114682 deri në 114683 RED; DHT02667 deri në DHT02671; DHT02675 deri në DHT02681; DHT02682 deri në DHT02682-01, bashkë me transkriptin TR dhe TR-ET.

Mbrojtja e Thaçit ka kërkuar pranimin edhe të katër materialeve në vijim. DHT02025 deri në DHT02029; DHT02030 deri në DHT02043, bashkë me përkthimin në anglisht ET. DHT02044 deri në DHT02047; dhe DHT02683 deri në DHT02684. Këto materiale i janë paraqitur dëshmitarit 03880 gjatë dëshmisë së tij në datën 9 tetor 2023.

ZPS-ja kundërshton pranimin e këtyre materialeve. Sa i

takon materialit të parë Trupi Gjykues vëren se ky material është një deklaratë dëshmitari të një personi që nuk është 03880, që paraqitet për vërtetësinë e përmbajtjes dhe që është paraqitur në kontekstin apo në lidhje me procesin ligjor. Sikurse është vendosur më herët nga Trupi Gjykues, deklarata të tilla janë objekt i rregullave 153 dhe 155. Nëse Mbrojtja dëshiron që të paraqiten, këtë duhet ta bëjë në përputhje me rregullat që sapo citova. Rrjedhimisht materiali DHT02025 deri në DHT02029 nuk pranohet.

Sa u takon tre materialeve të tjera, Trupi Gjykues është i bindur që janë relevante, pra kanë lidhje, veçanërisht sa i takon statusit të Dëshmitarit me numër 03880 dhe/ose Dëshmitarit 04828 në pika të ndryshme kohore, objekt i dispozitave përkatëse të ligjit të së drejtës ndërkombëtare humanitare. Gjithashtu, Trupi Gjykues vlerëson se tre materialet kanë tregues të mjaftueshëm të origjinës së tyre, dhe rrjedhimisht *prima facie* përmbushin kriteret e autenticitetit. Gjithashtu Trupi Gjykues vëren se dëshmitari nuk ishte në pozicion të komentonte sa i takon prejardhjes së këtyre dokumenteve dhe nuk mund të flasë për vërtetësinë e përmbajtjes së tyre.

Trupi Gjykues është po ashtu i bindur që këto materiale *prima facie* kanë vlerë provuese e cila nuk kundërpeshohet nga efekti cenues. Dëshmitari ishte në gjendje t'i autentikonte këto materiale në kuptim të njëmendtë, të komentonte

përmbajtjen e tyre, të konfirmonte vërtetësinë apo saktësinë e tyre, dhe kjo është një nga aspektet që do vlerësohet kur të vendoset për peshën e vlerën provuese që kanë këto dokumente.

Bazuar në sa më sipër, Trupi Gjykues është i bindur se janë përmbushur kriteret e rregullës 138(1). Rrjedhimisht në bazë të nenit 40(6)(h) të Ligjit dhe rregullës 138(1) të Rregullores, materialet pranohen dhe do të marrin numrin e provës materiale. Pra, materiali DHT02030 deri në DHT02043 bashkë me përkthimin në anglishte që përfundon me ET. DHT02044 deri në DHT02047; dhe DHT02683 deri në DHT02684.

Me kaq përfundon urdhri me gojë.

Sa i takon dëshmitarëve të radhës të bllokut të tretë të dëshmive, që fillon më 30 tetor, Trupi Gjykues dëshiron të sqarojë si në vijim.

Trupi Gjykues rikujton se në bazë të paragrafit 77 dhe Urdhrit për Zhvillimin e Procesit Gjyqësor, në fund të bllokut trejavor të dëshmive, pala që thërret dëshmitarët do të njoftojë Trupin Gjykues dhe palët e pjesëmarrësit e tjerë lidhur me dëshmitarët që synon të thërrasë gjatë bllokut të radhës të dëshmive, bllokut trejavor të dëshmive.

Trupi Gjykues gjithashtu rikujton se më 2 tetor 2023, ZPS-ja dorëzoi listën e dëshmitarëve për periudhën 30 tetor deri më 13 dhjetor 2023. Trupi Gjykues i kërkon ZPS-së të konfirmojë në fund të këtij blloku të dëshmive përkatësisht është e enjtja 19 tetor 2023, brenda orës 16.00, të njoftojë

lidhur me dëshmitarët që synon të thërrasë bllokun e radhës të dëshmitarëve që fillon më 30 tetor, si dhe në radhën apo renditjen se si do të paraqiten këta dëshmitarë. Veçanërisht, ZPS-ja duhet të na thotë nëse dëshmitari 04448 do të jetë ndër dëshmitarët që pritet të dëshmojnë në bllokun e radhës të dëshmive.

Me kaq mbyll urdhrin me gojë.

Tani do të vazhdojmë me dëshminë e dëshmitarit të Prokurorisë 04769. Vërej për procesverbal që të gjithë të akuzuarit janë të pranishëm fizikisht në sallën e gjyqit.

Asistente, ju lutem sillni dëshmitarin në sallë.

Z. KEHOE: [Përkthim] Gjykatës, sa i takon kundërpyetjeve --

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk ju dëgjojmë z. Kehoe.

Z. KEHOE: [Përkthim] Duam të ndjekim radhën e kundërpyetjeve. Desha të thoja që do fillojë z. Emmerson siç e bëmë dhe me kundërpyetjet dhe do të vijojmë siç vijuam kur bëmë kundërpyetjet ne si ekipet e Mbrojtjes në atë radhë.

[Dëshmitari vijon dëshminë]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, më dëgjon?

DËSHMITARI: Po.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes thashë në fillim.

DËSHMITARI: Mirëmëngjes.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të vazhdojmë me pyetjet nga Trupi Gjykues dhe pastaj do të ketë pyetje shtesë që burojnë nga pyetjet e Trupit Gjykues.

Ju lutem t'u përgjigjeni pyetjeve qartë, me fjali të shkurtra. Nëse nuk e kuptoni një pyetje lirisht kërkoni që pyetja të përsëritet apo të sqarohet. Gjithashtu na thoni ku e bazoni njohurinë, faktet dhe rrethanat për të cilat do të jepni përgjigje.

Ju kujtoj edhe një herë që jeni nën betim për të thënë të vërtetën sikurse vetë e cituat përmes deklaratës solemne.

Gjithashtu flisni pranë mikrofonit, dhe prisni pesë sekonda përpara se të përgjigjeni. Dhe flisni ngadalë që të kenë mundësi edhe përkthyesit t'ju ndjekin.

Tani, po vazhdoj me pyetjet e Gjykatësit Mettraux. Fillimisht duhet të kalojmë në seancë private.

Sekretare, të kalojmë në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit. Seanca rifillon në orën 12.00.

--- Pauza fillon në orën 11.27

--- Seanca rifillon në orën 12.00

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ftuese e gjyqit, ju lutem sillni dëshmitarin në sallë.

[Dëshmitari vijon dëshminë]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull, Dëshmitar, domethënë të vazhdojmë me pyetjet nga Gjykatësit. Gjykatësi Gaynor këtu në të majtë timen.

GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Mirëdita, dëshmitar.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar]

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pushim deri në orën 14.30.

--- Pushimi i drekës filloi në orën 13.31.

--- Seanca rifillon në orën 14.30

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Asistente, mund ta sillni dëshmitarin në sallë.

[Dëshmitari vijon dëshminë]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë, Dëshmitar. Na dëgjoni?

DËSHMITARI: Po.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jemi gati të vazhdojmë. Z. Emmerson, ka ende pyetje për ju.

Z. EMMERSON: [Përkthim] A mund t'i kthehemi dokumentin U000-6550.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju kërkojmë ndjesë duhet të kalojmë në seancë private. Është faji im nuk është faji i juaj.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARI E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë. Nesër në mëngjes do rifillojmë me dëshmitarin që e shtymë javën e kaluar. Do jetë orari i zakonshëm. Më duket se nuk kemi dëshmitar tjetër për këtë javë?

Z. HALLING: [Përkthim] Sikurse ju thashë dje, ne kemi një problem logjistik, në qoftë se zgjidhet ai do të kemi, në qoftë se jo nuk do kemi dëshmitar.

Z. EMMERSON: [Përkthim] Mbase nuk do të ishte -- ne mund ta kishim filluar që sot të paktën të krijonim një ide.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po i thamë të ikte në shtëpi sepse ju thatë që juve do ju nevojitej një orë.

Z. EMMERSON: [Përkthim] Atëherë ju kërkoj ndjesë në këtë rast.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Shihemi nesër në orën 9.00 të mëngjesit.

--- Seanca mbyllet në orën 15.28